

## Vendim nr.236, datë 19.3.2020 “Për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga covid”

Në kushtet e epidemisë të shkaktuar nga COVID-19, Qeveria Shqiptare nxorri disa vendime, disa prej të cilave garantojnë masa mbështetëse edhe për personat me aftësi të kufizuara. VKM nr.236, datë 19.3.2020, për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, parashikon ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë nga strukturat shtetërore.

Asistenca konsiston në dërgimin e pagesave mujore që shtresat në nevojë përfitojnë nga programi i mbrojtjes sociale, nga sigurimet shoqërore dhe në dërgimin e produkteve, ushqimore e joushqimore, minimale, barnave të rimbursueshme dhe atyre me kërkesë, për përballimin e situatës apo në kryerjen e furnizimeve me produktet e mësipërme, për llogari të tyre.

Sipas këtij vendimi, shtresa në nevojë konsiderohen:

a) Personat/familjet, të cilët nuk kanë familjarë të aftë për punë në njësinë administrative ku jetojnë, dhe që bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:

i. Familjet/ individët në nevojë, përfitues të ndihmës ekonomike;

ii. Personat me aftësi të kufizuara;

iii. Personat, të cilët përfitojnë pension pleqërie.

b) Personat, të cilët, pavarësisht përbërjes familjare dhe vendndodhjes së saj, bëjnë pjesë në grupet, si më poshtë vijon:

i. Familjet/individët në nevojë, të cilët janë të pastrehë;

ii. Familjet që kanë humbur banesën për shkak të tërmetit.

Për më tepër informacion shikoni vendimin, nr.236, datë 19.3.2020 për marrjen e masave për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë, në kushtet e epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, në linkun <https://qbz.gov.al/eli/vendim/2020/03/19/236/887aa15d-b34b-4867-a0da78f00480beac>